

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 204 Prot.

Tiranë, më 13.022017

VENDIM Nr. 24, datë 09.02.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 2 të datës 09.02.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit "Ndërtimi i Parkimeve te reja të fazës "B", dhe Mbulimi i parkimit ekzistues të fazës "A" në Aeroportin "Nënë Tereza", Tiranë- subjekti "STAR PARKING" sh.p.k., realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit "Ndërtimi i Parkimeve te reja të fazës "B", dhe Mbulimi i parkimit ekzistues të fazës "A" në Aeroportin "Nënë Tereza", Tiranë- subjekti "STAR PARKING" sh.p.k., realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Bazuar në nenin 48 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore"(i ndryshuar) nëse zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë. Drejtuesit dhe investitorët e punimeve njoftojnë, brenda tri ditëve, organet e qeverisjes vendore, Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, të cilët bëjnë kontrollin përkatës, raportojnë për vlerat e gjetura dhe bëjnë propozimet përkatëse për vazhdimësinë ose jo të punimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTER



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO